

E DREJTA PËR ARSIMIM

Disponueshmëria dhe qasja në arsimim

Fuqizimi përmes arsimimit

“....Arsimi duhet të drejtohet kah zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe kah forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”

Neni 26(2), DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT.

TREGIMI ILUSTRUES

Tregimi për Majan

“Quhem Maja. U linda 14 vjet më parë në një familje të varfër fshatare. Aty kishte mjaft fëmijë dhe kur u linda unë askush nuk ishte i lumtur. Kur isha ende e vogël, mësova t’i ndihmoja nënës dhe motrës sime më të vjetër në punë të shtëpisë. I pastroja dyshemetë, rrobat, bartja ujë dhe dru zjarri. Disa nga shokët e mi luanin jashtë, por unë nuk mund t’iu bashkohesha. Unë isha shumë e lumtur kur m’u lejua të shkoja në shkollë. Bëra shokë të ri atje, dhe mësova të shkruaj dhe të lexoj. Por, kur arrita në klasën e katërt, prindërit e mi më ndaluan nga shkolla. Babai im thoshte se nuk ka të holla për t’i paguar shpenzimet. Po ashtu, nevojitesha në shtëpi për t’i ndihmuar nënës dhe të tjerëve. Nëqoftëse do të më jepej zgjedhja për të lindur përsëri, do të preferoja të bëhesha djalë.”

BURIMI:

THE MILLENNIUM REPORT, UN. 2000.

>> *Jeto sikurse do të vdesësh nesër. Mëso sikurse do të jetosh përgjithmonë*<<
(Anonim)

PYETJE PËR DISKUTIM?

Cilat janë problemet kryesore të ilustruara në këtë rast? A ndjeni simpati për Majan, dhe veç kësaj, a mendoni se ka ndonjë mënyrë që ajo të ngritet nga varfëria dhe ta gjejë rrugën për arsimim? Nëse po, çfarë?

A mund t'i mendoni arsyet pse përqindja kaq e madhe e njerëzve analfabetë janë femra?

A mendoni se atje ka dije të ndryshme? Nëse po, cila dije është e rëndësishme? Cili lloj e humb rëndësinë?

A mendoni se e drejta për arsimim është momentalisht prioritet për komunitetin ndërkombëtar?

Përgjegjësi e kujt është zhdukja e injorancës dhe analfabetizmit?

Çfarë masash duhen të merren në mënyrë që të zhduket analfabetizmi?

A është arsimimi i rëndësishëm për gëzimin e të drejtave tjera të njeriut? Nëse po, përse?

A mendoni se arsimimi mund t'i kontribuojë sigurisë njerëzore? Nëse po, si?

E DOMOSDOSHME TË DIHET!?

1. HYRJE

Pse e drejta e njeriut për arsimim?

Afër 1 miliard njerëz hynë në shekullin XXI të paaftë që të lexojnë një libër apo të shkruajnë emrin e tyre. Shifra tregon për 1/6-ën e popullatës botërore apo sa e gjithë popullata e Indisë, dhe kjo vazhdon të rritet. E drejta për arsimim mund të karakterizohet si një “*e drejtë e aftësimi-fuqizimit*”. Një e drejtë e tillë i ofron individit më shumë kontroll për drejtimin e jetës së tij apo saj, në veçanti kontrollin mbi veprimet e shtetit kundrejt individit. Me fjalë të tjera, ushtrimi i të drejtës së aftësimi i ndihmon personit që t'i përjetojë të mirat e të drejtave të tjera.

Gëzimi i shumë të drejtave politike dhe civile, siç është e drejta për informim, liria e të shprehurit, e drejta për votim dhe për t'u zgjedhur, dhe shumë të tjera, varen nga së paku një shkallë minimale e arsimimit. Ngjajshëm, një numër i të drejtave ekonomike, shoqërore dhe kulturore, sikurse e drejta për zgjedhjen e punës, për të marrë pagë të njëjtë për punë të njëjtë, për të gëzuar të mirat e përparimit shkencor e teknik dhe për të marrë

arsimim të lartë në bazë të aftësive, mund të ushtrohet në mënyrë kuptimplotë nëse është arritur një shkallë minimale e arsimimit.

E njëjta mban të vërtetën për të drejtën e pjesëmarrjes në jetën kulturore. Për minoritetet etnike dhe gjuhësore, e drejta për arsimim është një mjet thelbësor për ta ruajtur dhe forcuar identitetin kulturor.

Arsimimi mund të nxisë (megjithëse nuk garanton) mirëkuptimin, tolerancën, respektin dhe miqësinë ndërmjet popujve, grupeve etnike apo religjioze dhe mund të ndihmojë krijimin e kulturës universale të të drejtave të njeriut.

Arsimimi dhe Siguria Njerëzore

Mohimi dhe shkelja e të drejtës për arsimim dëmton aftësinë e njerëzve që t'i zhvillojnë personalitetet e tyre, të mbështesin dhe ta mbrojnë vetveten dhe familjet e tyre, si dhe të marrin pjesë përshtatshëm në jetën shoqërore, politike dhe ekonomike. Në shkallën e gjerë të shoqërisë, mohimi i arsimimit dëmton çështjen e demokracisë dhe përparimit shoqëror, dhe si vazhdim, paqen ndërkombëtare dhe sigurinë njerëzore. Nëpërmjet arsimimit dhe mësimi për të drejtat e njeriut dhe për të drejtën humanitare, mund të ndalohen apo rregullohen shkeljet e të drejtave të njeriut dhe konfliktet e armatosura, si dhe mund të lehtësohet rindërtimi shoqëror pas përfundimit të konflikteve.

Arsimimi është më shumë se sa të mësohet leximi, shkrimi dhe llogaritja. Vet fjala në gjuhën latine do të thotë “*për të udhëhequr dikë jashtë.*” E drejta e personit për arsimim përfshinë mundësinë dhe qasjen në arsimim fillor, të mesëm dhe të lartë. Përderisa të vetdijshëm për konceptin e gjerë të së drejtës për arsimim, ky modul përqendrohet në arsimim elementar apo fillor, pasi që shumica e njerëzve janë të privuar madje edhe nga themelet e mësimi i cili zgjat sa vet jeta. E drejta e njeriut për arsimim siç është përcaktuar në Kartën për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, i referohet arsimimit pa pagesë në shkallën “*filllore dhe të domosdoshme*”. Megjithatë, shtetet e interpretojnë këtë kërkesë në forma të ndryshme.

Shumica e shteteve respektojnë obligimin që të ofrojnë arsimim “*fillor dhe të domosdoshëm*” pa pagesë për shkollimin fillor (shkalla e parë e shkollimit të rregullt). Në Evropë, Amerikën Veriore, Australi dhe në disa pjesë të Azisë, arsimimi “fillor” vazhdon

deri në arsimimin e plotë të mesëm; megjithëse, së paku 22 shtete në botë nuk kanë moshë për arsimim të detyruar fare.

Zhvillimi historik

Në Evropë para kohës së iluminizmit, arsimimi ishte së pari përgjegjësi e prindërve dhe kishës. Arsimimi filloi të bëhej çështje publike dhe përgjegjësi e shtetit vetëm me shfaqjen e shtetit laik modern. Në fillim të shekujve XVI dhe XVII, filozofët e shquar Xhon Lloku dhe Zhan Zhak Ruso në shkrimet e tyre aludojnë drejt koncepteve moderne të të drejtës individuale për arsimim.

Nga kontrasti, instrumente civile klasike siç ishte Karta Britanike e të Drejtave e vitit 1689, Deklarata e Virgjinias për të dejtat e vitit 1776, Deklarata Amerikane e Pavarësisë e vitit 1776 apo Deklarata Franceze për të Dejtat e Njeriut nuk kanë pasur as një të drejtë të ndërlidhur veçanërisht me të drejtën për arsimim.

Në shekullin XIX, shfaqja e socializmit dhe liberalizmit e vendosi arsimimin më fuqishëm në fushën e të drejtave të njeriut. Shkrimet e Marksit dhe Engelsit e përceptonin shtetin si një institucion atëror dhe bamirës. Mendimet liberale dhe anitklerikale të shekullit XIX gjithashtu ndikuan në definimin e të drejtës për arsimim të cilat u formuluan që të mbrojnë dhe përparojnë idetë e lirisë së shkencës, hulumtimit dhe mësimin kundër ndërhyrjes së kishës dhe shtetit.

Gjatë gjysmës së fundit të shekullit XIX u shfaq qartë njohja e të drejtës për arsimim. Më 1871 Kushtetuta e Perandorisë Gjermane përmbante një pjesë të titilluar "*Të Drejtat Themelore të Popullit Gjerman*", ngjashëm kushtetuta e Gjermane e Vajmarit e vitit 1919 përfshiu një pjesë për "*Arsimimin dhe Shkollimin*" e cila qartë njihte detyrën e shtetit që të garantojë arsimimin me anë të shkollimit të detyrueshëm dhe pa pagesë. Nënshkrimi i traktateve të ndryshme pas Luftës së Parë Botërore dhe proklamimi i Deklaratës së Gjenevës më 1924, i prinë njohjes ndërkombëtare të së drejtës për arsimim. Gjatë shekullit XX pikëpamjet e të drejtës për arsimim u përfshinë në kushtetutat shtetërore dhe Kartën Ndërkombëtare për të Drejtat, ose u njohën legjislacionet jokushtetuese apo të rëndomta vendore. E drejta për arsimim ka qenë qartësisht e përmendur në kushtetutat e pesëdhjetë e dy vendeve, për shembull, Nikaragua, Qipro, Spanja, Vietnami, Irlanda, Egjipti, Japonia, Paraguai dhe Polonia. Anglia dhe Peruja e kanë njohur të drejtën për

arsimim në legjislacionin jokushtetues, Korea Jugore, Maroko dhe Japonia e kanë njohur në të dyja, në kushtetutën e tyre dhe legjislacionin e rëndomtë.

Asnjë e drejtë për arsimim nuk është e përmendur në Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara. Gjykatat e SHBA-ve në të dyja nivelet - atë federal dhe shtetëror, kanë zhvilluar kapituj të caktuar për arsimim, veçanërisht lidhur me barazinë e mundësive për arsimim.

2. DEFINIMI DHE PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES

Përmbajtja e të Drejtës për Arsimim dhe Obligimet Shtetërore.

E drejta për Arsimim ka bazë solide në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ajo ishte e shtruar me kujdes në disa dokumente Regjionale dhe Universale për të Drejtat e Njeriut. Si shembujt janë, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (Neni 26), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Neni 13 dhe 14) Konventa për Eliminimit e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundë Gruas (Neni 10) dhe Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (Neni 28 dhe 29). Në shkallën regjionale janë, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut (Neni 2 i Protokollit të Parë), Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut (Neni 13 i Protokollit Shtesë të Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut në sferën e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore) dhe Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve (Neni 17).

E drejta themelore për arsimim u jep të drejtë të gjithë individëve që t'i sigurojnë format adekuate të sjelljes nga qeveria përkatëse. Shtetet kanë obligim të respektojnë, mbrojnë dhe t'i përmbushin të drejtat për arsimim.

Obligimi për respektim ia ndalon vetë shtetit që të veprojë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e njohura, ndërhyrjen me apo detyrim të ushtrimit të këtyre të drejtave apo lirive. Shtetet duhet, *inter alia (në mes të tjerash)*, të respektojnë lirinë e prindërve të zgjedhin shkollat private apo publike për fëmijët e tyre dhe të sigurojnë arsimimin moral dhe religjioz për fëmijët e tyre, në përputhje me bindjen e tyre. Nevoja për arsimimin e djemve dhe vajzave barabarësisht duhet të respektohet, sikurse për të gjitha grupet religjioze, etnike dhe gjuhësore. Obligimi për t'i mbrojtur kërkon nga shtetet që të

ndërmarrin hapa nëpërmjet legjislaturës apo mekanizmave të tjerë që të mbrojnë dhe ndalojnë shkeljen e të drejtave dhe lirive individuale nga persona të tretë. Shtetet duhet të sigurojnë që shkollat private nuk zbatojnë praktika diskriminuese apo nuk u shkaktojnë dënime trupore nxënësve. Detyrimi për përmbushjen në PNDESK mund të karakterizohet si një obligim për realizimin progresiv të së drejtës. Detyrimet e mbikëqyrjes dhe obligimet e rezultatit mund të dallohen. Detyrimet për mbikëqyrje obligojnë veprime apo masa të caktuar që shteti duhet të adoptojë. Shembulli më i mirë për këtë është Neni 14 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kluturore (PNDESK) sipas të cilit, palët e reja shtetërore të cilat nuk kanë siguruar ende arsimimin e detyruar fillor, obligohen;

“të hartojnë dhe të adoptojnë planin e detajuar të veprimit për zbatimin progresiv, brenda një numri të arsyeshëm të viteve...nga parimi i arsimimit të detyrueshëm pa pagesë për të gjithë.”

>>... arsimimi duhet të drejtohet kah zhvillimi e plotë i personalitetit njerëzor dhe ndjenja e dinjitetit të tij, dhe do ta forcojë respektin për të drejtat njerëzore dhe liritë themelore. Ata më tej pajtohen se arsimimi do t’u mundësojë të gjithë personave që të marrin pjesë efektivisht në shoqërinë e lirë, përkrah mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësisë së të gjitha kombeve dhe të gjitha grupeve racore, etnike apo religjioze; dhe i përparon veprimtaritë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.<< Neni 13(1) Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike (PNDKP)

Standardet që duhet të arrihen;

Arsimim fillor i detyruar dhe pa pagesë;

Disponim i arsimimit të mesëm i cili është i lejuar për të gjithë;

Arsimim i lartë i lejuar për të gjithë, në bazë të kapaciteteve;

Shtimin e arsimimit themelor për ata që nuk e kanë kryer arsimimin fillor;

Eliminimi i analfabetizmit dhe injorancës, nëpërmjet mjeteve të kooperimit ndërkombëtar, duke marrë parasysh nevojat e veçanta të shteteve në zhvillim

Kjo do të thotë se përmirësimi i qasjes në arsimim për të gjithë, në bazë të parimit të barazisë dhe jodiskriminimit dhe lirisë për të zgjedhur llojin dhe përmbajtjen e shkollës, paraqet shpirtin dhe thelbin kryesor të të drejtës për arsimim. Komenti Gjeneral 13 i Komitetit nën Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK) identifikon katër elemente të detyrimeve shtetërore luidhur me të drejtën për arsimim. Ato janë: disponueshmëria, mundësia e kyçjes, pranueshmëria dhe adaptueshmëria.

Disponueshmëria

Detyra për të siguruar arsimim fillor të detyruar dhe pa pagesë është pa dyshim një parakusht i realizimit të së drejtës për arsimim. Sigurimi i shkollave të gatshme fillore për të gjithë fëmijët kërkon një angazhim të konsiderueshëm financiar dhe politik. Përderisa shteti nuk është ofruesi i vetëm i arsimimit, e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut e detyron atë të jetë ofruesi i fundit dhe të sigurojë se shkollat fillore mundësohen për fëmijët e të gjitha moshave. Në qoftë se kapaciteti i pranimit të shkollave fillore është më i vogël se numri i fëmijëve të moshës shkollore, atëherë obligimet legale të shtetit sa i përket arsimimit të detyruar nuk janë zbatuar në praktikë, dhe qasja në arsimim do të mbetet nevojë që do të realizohet si e drejtë.

Dispozitat e arsimimit sekondar apo terciar janë po ashtu një element i të drejtës për arsimim. Kushti i “*hyrje përparimtare e arsimimit të lirë*” nuk do të thotë se shteti mund shfajësohet nga obligimet e tij.

>> *Arsimimi i femrës është arsimimi i familjes, komunitetit, kombit.* <<

PROVERBË AFRIKANE

Qasja

Si minimum, qeveritë janë të detyruara që të sigurojnë realizimin e së drejtës për arsimim nëpërmjet garantimit të qasjes në institucionet ekzistuese nga të gjithë, vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat, në bazë të **barazisë dhe pa dallim**.

Zotimi pohues që të sigurohet qasje e barabartë në institucionet e arsimimit përfshin ato fizike dhe konstruktive. Qasja fizike në institucione është me rëndësi të veçantë për të vjetrit dhe të hendikepuarit. Qasja konstruktive nënkupton se barrierat e

përrjashtueshmërisë duhet të largohen, për shembull eliminimi i koncepteve stereotipe të rolit të mashkullit dhe të femrës nga tekstet shkollore dhe strukturat arsimore, siç parashikon Neni 10 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas (KEFDG).

Pranueshmëria

Raportuesja Speciale për të Drejtën në Arsimim, *Katarina Tomasevski*, ka thënë në njërin nga raportet e saj se “*shteti është i detyruar të sigurojë se të gjitha shkollat përputhen me kriterin minimal i cili zhvillohet, po ashtu, si përcaktim se arsimimi është i pranueshëm për prindërit dhe fëmijët.*”

Ky element përfshin të drejtën e zgjedhjes së arsimimit të pranuar, dhe të drejtën për themelimin, mbajtje, drejtim dhe kontroll në institucionet private arsimore. Nxënësit dhe prindërit kanë të drejtë të jenë të lirë nga indoktrinimi si i tillë, studimi i detyrueshëm i materialeve që nuk janë në përputhshmëri me besimin religjioz apo besimet e tjera se nxënësi mund ta shkelë të drejtën për arsimim. Çështja e **gjuhës së instruksioneve** ka shkaktuar polemikë. Nuk ka të drejtë të pergjithshme ndërkombëtare të njeriut për mësimin e gjuhës amtare në shkollë kur i përket pakicës gjuhësore të vendit. Neni 27 i PNDCP shpall se *praktikimi i gjuhës* nuk duhet të mohohet, por ai mbetet i heshtur për çështjen e gjuhës amtare. Në *Konventën Kornizë për Mbrotje të Pakicave Kombëtare*, Këshilli i Evropës e ka njohur të drejtën e të mësuarit të gjuhës amtare, por nuk e ka njohur njëkuptimisht të drejtën për të pranuar mësimdhënie në gjuhën amtare.

Karta Evropiane për Gjuhë Rajonale apo të Pakicave ka shkuar një hap më larg në përkrahje të së drejtës për arsimin në gjuhën amtare, si një e drejtë zgjidhje për ato shtete të cilat e kanë nënshkruar Kartën; qëllimi i dygjuhësisë së pakicave në ato vende është i njohur nga shteti.

Megjithatë, ka pakica të cilët nuk janë të mbrojtura në këtë mënyrë dhe nuk kanë as të drejtë të mësojnë gjuhën e tyre amtare, siç janë romët në Evropë dhe aborigjinët në Australi.

Adaptueshmëria

Normalisht, ajo që fëmija mëson në shkollë duhet të përcaktohet nga nevojat e atij apo asaj për të ardhmen. Kjo nënkupton se sistemi edukativ duhet të jetë i adaptueshëm, duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës, por edhe zhvillimin social dhe përparimin në shkallë nacionale dhe ndërkombëtare.

Përgjegjësia e sigurimit të arsimimit për të ndihmuar përmbushjen e të drejtës për siguri, duhet të jetë qendrore në kuptimin e kërkesave të sigurisë njerëzore. Qeveritë obligohen të sigurojnë që të drejtat e njeriut në arsimim janë të respektuara, të mbrojtura dhe të përmbushura. Megjithatë, përgjegjësia e ushtrimit të këtyre detyrave dhe zotimi nuk është vetëm çështje e shtetit. Është po ashtu detyrë e shoqërisë civile që të përkrahë dhe asistojë për zbatimin e plotë të së drejtës për arsimim.

3. PRESPEKTIVAT NDËRKULTURORE DHE ÇËSHTJET KONTRAVERSE

Sot, shqyrtimi i raporteve shtetërore dhe varësia nga indikatorët e përkohshëm janë metodat më efektive për të kontrolluar çështjen. Këta indikatorë na tregojnë pabarazinë në zbatimin e të drejtës për arsimim në rajone të ndryshme botërore.

AFRIKA E NËNSAHARËS

Regjistrimi: Nga 25 % në 1960, regjistrimi rajonal primar është ngritur afërsisht 60 % deri më 1980. Pas një rënijeje më 1980, regjistrimi është përsëri afërsisht 60%. Më shumë se 40 milionë fëmijë të moshës për shkollë fillore nuk janë në shkolla.

Gjinia: Hapësira është ngushtuar shumë, me shkallën e pjesëmarrjes së vajzave prej 57 % dhe të djemve prej 61% (Megjithatë, Benini si shembull ka pabarazinë më të madhe në regjistrimin fillor, me shkallën e vajzave 30% më të ulët se ajo e djemve.)

Efektiviteti: Në rajon, një e treta e fëmijëve të regjistruar në shkollat fillore braktisin ato, para se të arrijnë në klasë të pestë.

Përmbajtjet: Konfliktet e armatosura dhe presionet ekonomike nga borxhet dhe politikat strukturore të rregullimit kanë ndikuar në një masë të madhe në arsimim. Rajoni përfshin

rreth 30 shtete të zhytura në borxhe, dhe qeveritë shpenzojnë në borxhe, aq sa në shëndetësi dhe arsimimin fillor së bashku.

Përparimi dhe risitë: Në mes të shteteve që e arrijnë shkallën e regjistrimit fillestar 90 % apo më shumë janë: Botsuana, Kepi i Gjelbër, Malavi, Mauritania, Afrika Jugore dhe Zimbabveja.

Amerika Latine dhe Karaibet

Regjistrimi: Kyçja ne arsimimin fillestar është pothuaj universale, me një regjistrim me më shumë se 90 %.

Gjinia: Megjithëse diskriminimi kundrejt gruas dhe vajzava është problem në rajon, regjistrimi fillestar i vajzave ka qenë i njëjtë me atë të djemve për dekada.

Efektiviteti: Niveli i lartë i brakisjes dhe përsëritja e klasëve janë një problem serioz.

Përmbajtjet: Rajoni ka pabarazitë më të larta në mes të të pasurve dhe të varfërve, dhe popullsia vendëse dhe e varfëruar përballen me vështirësi që të kenë kyçje në arsimimin kualitativ.

Përparimi dhe risitë: Regjistrimi ne shkollat fillore është ngritur nga nën 60% në vitin 1969 në 90%.

EVROPA LINDORE DHE QENDRORE, SHTETET E PAVARURA TË KOMONUELTIT DHE SHTETET BALTIKE

Regjistrimi: Qasja universale per arsimimin bazik të lirë është arritur në fillim të viteve '80.

Gjinia: Është një paritet ndërmjet djemve dhe vajzave të regjistruara në shkollat fillore dhe shkallës së përfundimit të saj.

Efektiviteti: Në shkollat fillore ekzistuese, shkalla e përfundimit duket të jetë mbi 90%, përafërsisht një e treta e vendeve në rajon nuk kanë të dhëna të kompletuara.

Përmbajtjet: Investimi real publik në arsimim ka dështuar në shume vende, nga një e treta e Federatës Ruse dhe nga tre të katërtat ose më shumë në Azerbejxhan, Bullgari, Gjerogji dhe Kirgistan. Shumë ndërtesa të shkollave kanë nevojë të riparohen dhe ngrohja është problem në disa vende.

Përparimi dhe risitë: Reformat arsimore janë në agjendat e disa prej shteteve.

VENDET E INDUSTRIALIZUARA

Regjistrimi: Regjistrimi fillestar në shtetet e industrializuara qëndron afërsisht 100 %.

Gjinia: Ka një barazi në mes shkallës së regjistrimit të vajzave dhe djemve në nivele fillore dhe të mesme.

Efektiviteti: Në vitet '60, vetëm gjysma e njerëzve në vendet e industrializuara mbaronin shkollën e lartë. Deri më 1980, përpjestimi u rrit në dy të tretat dhe vazhdoi të rritet. Megjithatë, një mesatare pre 15% e të rriturve në 12 vendet e industrializuara janë analfabetë; në Irlandë, Mbretëri të Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, shkallët janë më shumë se 20 %.

Përmbajtjet: Nuk është befasi që varfëria çon në nivele më të ulta akademike dhe shkallë më të larta të braktisjes.

Përparimi dhe risitë: Më shumë se tre të katërtat e fëmijëve të rinj në Evropën Përendimore janë në programe parashkollore.

BURIMI:

UNICEF, 1999.

Pavarësisht nga përparimi i mrekullueshëm në orvatjet për t'ua mundësuar fëmijëve që t'i gëzojnë të drejtat e tyre për arsimim, një pjesë e madhe e punës mbetet për t'u bërë në mënyrë që të arrihen qëllimet. Ende ka shumë çështje të pazgjidhura të diskriminimit, pabarazisë, shpërfilljes dhe shpërdorimit, që prek vajzat, gratë dhe pakicat. Andaj, shoqëritë duhet t'i shpejtojnë përpjekjet që t'i adresojnë veprimet kulturore dhe shoqërore që i kontribuojnë direkt pasigurisë së këtyre grupeve dhe i ndalojnë ato t'i gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre.

4. ZBATIMI DHE MONITORIMI

Që nga zanafilla më 1945, Kombet e Bashkuara kanë njohur nevojën e *“bashkëpunimin ndërkombëtar për zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare të karakterit ekonomik, social, kulturor dhe politik.”*

Bashkëpunimi ndërkombëtar, nëpërmjet shkëmbimit të informatave, diturisë dhe teknologjisë është qenësor për realizimin efektiv të së drejtës për arsimim, veçanërisht për fëmijët në vendet e pazhvilluara. Është vëzhguar dhe studiuar se e drejta për arsimim është një nevojë ekonomike nga e cila varet zhvillimi i vendit. Përkujdesja për arsimimin duhet të konsiderohet nga të gjitha shtetet si një investim afatgjatë me prioritet të lartë, për arsye se zhvillon burimet njerëzore, si një pasuri në procesin e zhvillimit kombëtar.

Fondet ndërkombëtare, si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) theksojnë rëndësinë e arsimimit i cili shihet si një investimin në kapitalin njerëzor. Megjithatë, saktësisht këto institute i detyrojnë qeveritë që t'i shkurtojnë shpenzimet publike, përfshirë ato të ndërlidhura me arsimim, si rezultat i kushteve të rrepta që i kanë në Programet për Rregullim Struktural.

Konferenca Botërore për Arsimim për të Gjithë, e vitit 1990 e mbajtur në Tajlandë, kumtoi se masat efektive për arsim për të gjithë varen nga qëndrimi dhe dëshira politike e mbështetur nga

“zbatimi efektiv i të drejtës së fëmijës për arsimim është së pari çështje e dëshirës. Vetëm dëshira politike e qeverive dhe e bashkësisë ndërkombëtare mund të shtyjë përpara këtë të drejtë themelore deri në masë të tillë që të kontribuojë për përmbushje nga çdo individ dhe të përparimit të çdo shoqërie”
AMADOU-MAHATAR
M'BOW, ish-drejtor gjeneral i UNESCO-s

politikat e përshtatshme fiskale, ekonomike, tregtare, punësimi dhe shëndetësia. Një studim i UNICEF-it që përfshin nëntë vende ka gjetur 6 tema të gjera për të arritur rezultate më të mira, që të sigurojë të drejtën universale për arsim fillor. Këto janë: zotimi politik dhe financiar, roli qendror i sektorit publik, paanësia në sektorin publik, zbritja e kostos së edukimit për shtëpi, dhe shkrirja e reformave arsimore në strategjitë e gjera të zhvillimit njerëzor.

Forumi Botëror i Arsimit, i mbajtur në Dakar nga 26 deri 28 Prill 2000, ka qenë evoluimi më i madh i bërë ndonjëherë në fushën e arsimit. Në të u përfaqësuan 164 shtete të përfaqësura, së bashku me më shumë se 150 grupe të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe OJQ-të. Përgatitjet për forum ishin bërë në tërësi. Një masë e konsiderueshme e informatave ishte mbledhur duke theksuar situatat e ndryshme nga një shtet në tjetrin, me disa shtete të cilat kishin bërë një përparim të mrekullueshëm dhe të tjerat që po përjetonin probleme në rritje në fusha të ndryshme të arsimit. Përparimi i dalë nga forumi ishte miratimi i Kornizës së Dakarit për Veprim. Trendet.

Është kërkuar mbështetje e **fuqishme institucionale** për zbatim të plotë të së Drejtës për Arsimim. Vetë UNESCO luan rolin udhëheqës për këtë çështje sepse arsimi është fusha kryesore dhe specialiteti i saj. UNESCO ka qenë ndihmues për nisjen e reformave arsimore dhe për shtytjen e zbatimit të plotë të së drejtës për arsimim, si dëshmi e përmbledhjes së gjerë të instrumenteve për standardizim, dokumenteve të ndryshme, raporteve, por edhe të një numri të madh të forumeve, takimeve, grupeve punuese, dhe aktiviteteve të koordinimit dhe bashkëpunimit me shtetet, organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare dhe OJQ-të. Si rrjedhojë e kësaj UNESCO është agjencioni udhëheqës për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e arsimit. UNESCO ka zhvilluar një numër mekanizmash të disenjuar për të lejuar aplikimin më efektiv të masave të adoptuara dhe për të siguruar një përmbushje më të mirë të obligimeve të marra në lidhje me të drejtën për arsimim. Raportet periodike të cilat u kërkohen shteteve kanë një efekt të informimit për masat e marra në vendet e tyre, për t'i përmbushur detyrimet e tyre sipas konventës palë nënshkruese e të cilës janë. Palët shtetërore nënshkruese të Konventës Kundër Diskriminimit në Arsimim, duhet të japin informata në raportet e tyre periodike në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s, për masat e marra legislative dhe administrative, të cilat i kanë miratuar, apo edhe për veprime të tjera të ndërmarra për

zbatimin e konventës. Në mënyrë që të sigurojnë operim të mirë, UNESCO ka ndërtuar mekanizma ndihmëse për t'i analizuar raportet e shteteve anëtare, siç është Komisioni i Konventave dhe Rekomandimeve.

Komiteti për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, si trup mbikëqyrës, është i përgjegjshëm për monitorimin dhe zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kluturore brenda palëve shtetërore. Ai provon raportet nacionale të dorëzuar rregullisht nga këto shtete dhe vazhdon dialogun me ta, në mënyrë që të sigurojë zbatimin më efektiv të të drejtave të mbrojtura me Konventën Ndërkombëtare.

Arsimimi nuk është mënyrë për t'i ikur varfërisë së vendit. Është mënyrë për ta luftuar atë.
JULIUS NEYRERE

Realizimi i plotë i të drejtës për arsimim mund të arrihet duke përmirësuar sistemin

e raportimit dhe monitorimit dhe me një vendosmëri më të madhe nga ana e shteteve që t'i përmbushin **obligimet e raporteve** sipas instrumenteve ndërkombëtare, vazhdimisht dhe në besim të plotë. Si edhe me të drejtat e tjera ekenomike, sociale dhe kulturore, monitorimi i zbatimit të së drejtës për edukim në baza përparimtare do të përfitojë nga përvetësimet dhe përdorimet e treguesve të sigurt, siç janë krahasimi ndërnacional dhe pozicioni i vendit. Në fushën e arsimimit, treguesit e sigurt të hulumtimeve të kohëpaskohshme, përfshirë ato të shkallës së shkrim-leximit, përqindjet e regjistrimit, përqindjet e braktisjes dhe e përfundimit, dhe e shpenzimeve publike në arsimim, si përqindje e shpenzimeve totale publike ose në krahasim me sektorët e tjerë, si ai i forcave të armatosura.

Porblemet e zbatimit

Siç e kishte vërejtur me zgjuarësi një komentator, nuk është e mjaftueshme që të deklarohen parimet kryelarta, në qoftë se ato mbeten vetëm në letër, për arsye se metodat e zbatimit të tyre janë konfuze apo të gjymta.

Të drejtat sociale, ekononmike dhe kulturore shpesh kërkojnë pjesë të mjaftueshme të shpenzimit të kapitalit gjatë kohës së zbatimit të tyre efektiv. Në të vërtetë, në përvojën e shumë vendeve, arsimimi përbën njërin nga shpenzimet kryesore qeveritare.

Shpesh, pengesa kryesore e vonesës së fëmijëve për ushtrimin e të drejtës për arsimim në një shtet në zhvillim është **varfëria**.

Liria nga moduli i varfërisë.

Problemi nuk qëndron se fëmijët nuk kanë shkollë që t'i vijojnë. Në fakt, më shumë se 90% e fëmijëve të vendeve në zhvillim e fillojnë shkollën fillore. Problemi qëndron në shifra të larta të braktisjes së shkollës nga nxënësit dhe përsëritjes së vitit të njëjtë shkollor. Mungesa e fondeve i pengon autoritetet që t'i ndërtojnë dhe t'i mirëmbajnë shkollat, programet për trajnimin e mësuesve, rekrutimin e mësuesve dhe personelit administrativ kompetent, ofrimin e materialeve për mësues dhe mjeteve të tjera, dhe ofrimin e sistemit të përshtatshëm të transportit për nxënës. Të gjitha këto varen në mënyrë direkte nga rezervat e shtetit. Gjithashtu, varfëria ua bën më të vështirë familjeve, që të paguajnë tarifën për shkollë dhe koston e materialeve shkollore dhe librave, ose kur shkolla është pa pagesë, dërgimi i fëmijës në shkollë është të kontribuosh në hollimin e buxhetit të familjes. Një studim i bërë nga “*Fondacioni Shpëtoni Fëmijët*” nxori në pah se si rezultat i ngarkesës së borxheve, shtetet afrikane janë të detyruara nganjëherë që t'i imponojnë apo t'i rrisin tarifën e shkollimit, duke e rritur në këtë mënyrë koston e arsimit për familjet. Si rezultat, miliona fëmijë kurrë nuk kanë vijuar shkollën, apo kanë dështuar të mbarojnë edukimin fillor.

Edhe një faktor, në shumë shtete, është përdorimi i gjerë i fëmijëve si **fuqi punëtore**. Moduli i punës.

Fatkeqësisht, shumë familjeve iu duhet kjo e hyrë plotësuese që të mund ta arrijnë fundin e muajit. Mungesa e burimeve ekonomike si dhe varfëria pengojnë fëmijët për pjesëmarrje dhe përfitim nga shanset e arsimit. Varfëria prodhon uri dhe paushqyeshmëri, e cila mund ta dëmtojë përfundimisht trurin e fëmijës.

Nxënësi mesatar në Zambë ecën shtatë kilometra çdo mëngjes për të arritur në shkollë, pa ngrënë, i lodhur dhe i dërrmuar nga parazitët e zorrëve. Ai apo ajo ulet në klasë me 50 nxënës të tjerë, të cilët ndodhen në kushte të ngjashme. Perceptimi i tyre është minimal. Dëgjimi është i keq. Nuk ka shkumës dhe nuk ka shumë fletore

>>Arsimimi është mbrojtës më i mirë i lirisë, sesa një armatë e tërë<<

EDUARD EVEETT

Varfëria dhe fuqia punëtore e fëmijëve janë një pengesë e madhe për **arsimimin e vajzave** në veçanti. Moduli i të drejtave për femra. Shumë vajza duhet të pranojnë punë shumë të rënda në moshë mjaft të re, në mënyrë që të mbijetojnë. Jo vetëm që pritet nga ato që t'u përgjigjen nevojave familjare dhe t'i marrin përsipër detyrat e punës, por ato përballen me paragjykimet shoqërore për amësi të re dhe qëndrime të vjetra tradicionale. Këto këndvështrime tradicionale, dritëshkurtra dhe të njëanshme, sa i përket arsimimit të vajzave, ende mbizotërojnë, dhe rezultati i fundit është mungesa e motivit të prindërve që t'i dërgojnë vajzat në shkollë. Grupe të veçanta të vajzave, siç janë ato të rrënjës së bashkësive nomade, minoriteteve etnike dhe vajzat e braktisura dhe të hendikepuara, përballen me situatë veçanërisht të pafavorshme.

Si pasojë është rritja e brengosjes ndërkombëtare që të ofrohet përfshirje e barabartë në arsimim për vajzat dhe kështu t'u mundësohet që ta përmbushin potencialin e tyre njerëzor.

Konfliktet e armatosura të brendshme dhe ndërkombëtare.

Moduli i të drejtave të njeriut në konflikt të armatosur, dhe lufta civile mund të përçajjnë motivin normal të jetës. Shkollimi i rregullt për nxënësit mund të jetë i pamundshëm kur shkollat gjenden afër rajoneve të konfliktit. Edhe pse janë të mbrojtura me ligjin ndërkombëtar humanitar, shkollat shumë shpesh janë cak i sulmeve.

Shtetet në konflikt gjatë viteve të 90-ta: Algjeria, Burundi, Kongo, Bregu i Fildishtë, Etiopia, Ish-Jugosllavia, Gambia, Guinea-Bisau, Haiti, Lesoto, Nigeria, Pakistani, Ruanda, Siera Leone, Somalia etj.

A E DINI SE:

Arritja e arsimimit fillor botëror në një deçenie në shtetet në zhvillim do të kushtojë 7-8 miliardë në vite, që përfaqëson: rreth shtatë ditë 'vlerë të shpenzimeve ushtarake botërore, shtatë ditë' vlerë të transaksioneve financiare në tregjet ndërkombëtare, më pak se gjysmën e vlerës që prindërit amerikano-verior e shpenzojnë për lodrat e fëmijëve të tyre çdo vit.

E DOBISHME TË DIHET

PRAKTIKA TË MIRA

- Në **Egjipt** qeveria është duke integruar një koncept të suksesshëm të bashkësisë së shkollave të shoqërisë së vajzave në arsimimin fillor dhe ka nisur një program gjithëpërfshirës të reformave, me qëllim që të nxjerrë shkolla të shëndosha.
- **Malavi** ka hequr kostot e shkollimit për prindërit, duke i eliminuar tarifat shkollore dhe duke hequr uniformat e detyrueshme për nxënësit.
- Programi Busti në **Pakistan**, i cili është një bashkëpunim në mes të një OJQ-je të lokalizuar në Karaçi dhe UNICEF-it dëshiron të ofrojë edukim bazë për fëmijët, të cilët pastaj do të pranoheshin në shkolla fillore. Moshë e përfshirë në këto grupe është nga pesë deri dhjetë vjeç- rreth tri të katërtat e fëmijëve janë vajza. Kjo iniciativë është treguar e suksesshme për kthimin e pjesës së barazisë gjinore, duke ofruar arsimim nëpër shtëpi. Ajo ka themeluar më shumë se 200 shkolla-shtëpi, duke regjistruar rreth 6000 nxënës, me një kosto prej 6 \$, shumë më lirë se mesatarja e kostonë në shkollat fillore shtetërore.
- **Mauritania** ka miratuar ligjet për ndalesën e martesave të hershme dhe për arsimin e obliguar fillor, duke e bërë moshën 16 vjeçare, si moshë minimale të lejuar për punë. Ka themeluar Këshillin për Fëmijë për të promovuar zbatimin e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe në qytetet kryesore ka promovuar themelimin e gjykatave për të rinj.
- Në qarkun Mashan në **Kinë**, fshatarëve dhe familjeve që marrin masa efektive për t'i dërguar vajzat në shkollë, u jepet përparësia për kredi apo fonde të zhvillimit.
- Populli i Republikës Demokratike të **Laosit** është duke zbatuar me sukses një disenzhim gjithëpërfshirës të barazisë gjinore, i cili garanton përfshirje në edukimin fillor kualitativ për vajzat në zonat e pakicave. Pikësynimi afatgjatë është që të sillen më shumë vajza në rrjedhën e përgjithshme të zhvillimit ekonomik, duke avancuar shkallën e tyre të arsimimit.
- Në Mumbaj (ish Bombajin) në **Indi**, Nisma Arsimore Pratham e Mumbajit, një partneritet në mes edukatorëve, grupeve të bashkësisë, sponsoruesve të

korporatave dhe zyrtarëve qeveritarë, ka themeluar 1600 shkolla dhe ka ndihmuar të modernizohen rreth 1200 shkolla fillore.

- Në **Afganistan**, ku vajzat ishin të përjashtuara nga sistemi zyrtar i edukimit, UNICEF-i ka marrë një hap të vështirë duke i mbështetur shkollat-shtëpi për djem dhe vajza. Që nga 1999 deri në fund të 2001, në shkollat-shtëpi ishin duke i mësuar rreth 58.000 fëmijë.
- Projekti CHILD (Fëmija) në **Tajlandë** filloi me donacione siç janë kompjuterët e monitorët e dorës së dytë, dhe duke mbikëqyrur ndërlidhjet në mes mësimit të fëmijëve dhe shëndetësisë.
- Programi zhvillimor i Dekadës për Arsimim (PRODEC) është një program me qëllim kryesor arritjen e shkallës së regjistrimit deri 75% në **Mali** deri në vitin 2008.

Qendrat për Zhvillimin e Arsimit (QZHA) janë institucione arsimore në Mali, të cilat frekuentohen nga fëmijët e moshës 15 vjeçare, të cilët nuk mund të përfitojnë nga shkollat. Atyre u mësohen njohuri fillestare për gjuhën e tyre dhe të profesionit. Çdo klasë ka 30 vijues-15 djem dhe 15 vajza.

- **Akcioni i UNESCO's** për arsimim është i ndërtuar përreth tri strategjive:
Promovimin e arsimimit, si e drejtë themelore;
Përmirësimin e kualitetit të arsimimit
Promovimi i eksperimentimeve, shpikjeve dhe shpërndarja e informatës dhe praktikave më të mira, si dhe dialogu si politikë në arsim.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut ka krijuar një Raportues Special për të Drejtën në Arsimimit më 1997, me mandat të raportimit mbarëbotëror lidhur me gjendjen e përparimit të realizimit të së drejtës për arsimim, duke përfshirë këtu edhe përfshirjen në arsimin fillor, si dhe vështirësitë që ndeshen gjatë zbatimit të kësaj të drejte.

2. TRENDET

Korniza e Dakarit për Veprim – Arsim për të Gjithë e miratuar në Forumin Botëror të Arsimimit (Dakar, Senegal, 26 deri 28 Prill 2000) shpreh vendosmërinë e bashkësisë

ndërkombëtare për realizimin e plotë të së drejtës për arsimim. Korniza e Dakarit për Veprim përcakton gjashtë synime për arsimin fillor deri më 2015:

1. Zgjerimi dhe përmirësimi gjithëpërfshirës i kujdesit dhe arsimimit fëmijënor, në veçanti për fëmijët e prekshëm dhe të dëmtuar;
2. Sigurimi se deri në vitin 2015 të gjithë fëmijët, e veçanërisht vajzat, fëmijët me kushte të vështira dhe ata që u përkasin pakicave kombëtare, të kenë qasje në arsimimin e obligueshëm fillor të kualitetit të lartë dhe pa pagesë;
3. Sigurimi se do të plotësohen të gjitha nevojat e mësimi për të gjithë të rinjtë dhe të rriturit, me një qasje të barabartë në përvetësimin e mësimëve dhe programeve të aftësimi jetësor;
4. Arritja e përmirësimi prej 50 % të shkrim-leximit të të rriturit, në veçanti të femrat, dhe qasje të barabartë për arsimim fillor dhe atë në vazhdim, për të gjithë të rriturit;
5. Eliminimi i kontrastit gjinor në arsimin fillor dhe të mesëm deri në vitin 2005, dhe arritja e barazisë gjinore në arsimim deri më 2015;
6. Përmirësimi i të gjitha aspekteve të kualitetit të arsimimit dhe sigurimi i përsosmërisë për të gjithë, në mënyrë që rezultati i mësimi të akredituar dhe mesatar të jetë i arritur nga të gjithë, veçanërisht në shkrim-lexim dhe aftësi themelore jetësore.

Arritja e arsimit fillor universal deri më 2015 e komunikuar në Samitin e Mileniumit në shtator të vitit 2000 është njëri nga qëllimet e zhvillimit të mijëvjeçarit.

Tabela grafike duhet të futet

Situata momentale me vëmendje për arritjen e arsimit fillor universal:

51 shtete, me rreth 40 përqind të numrit botëror të popullsisë, janë në rrugë për arritjen e Arsimit Fillor Universal deri në vitin 2015 apo e kanë arritur. Por 24 shtete kanë mbetur mbrapa, apo janë larg nga ky pikësynim – dhe 93 vende, me rreth 40 përqind të popullsisë botërore, nuk kanë të dhëna për ta mundësuar vlerësimin. Një në çdo gjashtë fëmijë në botë, të moshës së shkollës fillore nuk shkon në shkollë. Benini me një Bruto Produkt Kombëtar (BPK-GDP) për kokë banori prej 990\$- është në rrugëqë të fusë në shkollë të gjithë fëmijët e moshës së shkollës fillore, deri në vitin 2015, kurse Katari, me të ardhura 20 herë më të mëdha ka ngelur shumë më mbrapa.

Të ardhurat për kokë banori në Egjipt janë më të ulëta se e një e treta treta në Hungari, por Egjipti është në rrugë për të arritur regjistrim fillor universal, kurse Hungaria ka ngecur mbrapa.

BURIMI: RAPORTI MBI ZHVILLIMET NJERËZORE 2002, UNDP.

Regjistrimi i përgjithshëm i shteteve në zhvillim u rrit nga 50 % në vitin 1970, në 80 % në vitin 1990 dhe në 84 % në vitin 1998. Shkalla e shkrim-leximit në shtetet në zhvillim po ashtu u rrit nga 43% në vitin 1970, në 65 % në vitin 1990 ,dhe në më shumë se 70 % në vitin 1995. Megjithatë, si kontrast i këtij pasqyrimi, disa fakte të kundërta me këto, mund të shihen në stagnimin e regjistrimit në shtetet e tjera.

Nga numri i përgjithshëm botëror prej 854 milionë të rriturish analfabetë, 544 milion janë gra.

60 % e fëmijëve të cilët nuk janë në shkollë fillore rrethpërqark botës janë vajza.

Regjistrimi i vajzave në shkollë fillore është duke u përmirësuar, ashtu si edhe ai i djemve. Ekziston një brengosje, megjithatë, se hapësira po rritet. 113 milionë fëmijëve të moshës së shkollës fillore u është refuzuar e drejta për arsimim. 97 % e tyre janë nga vendet në zhvillim. 93 vende me 39 % të popullsisë botërore nuk kanë të dhëna mbi regjistrimin fillor.

3. KRONOLOGJIA

1948: Në Deklaratën Universale, arsimimi është deklaruar si e drejtë themelore e çdo qenieje njerëzore.

1959: Deklarata për të Drejtat e Fëmijëve është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Arsimimi është shpallur e drejtë e çdo fëmije.

1960-1966: Konferenca Rajonale Botërore për Arsimim e UNESCO-s.

1969: Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha formave të Diskriminimit Racor hyn në fuqi, duke e proklamuar të drejtën e të gjithëve për arsimim, pa marrë parasysh racën apo përkatësinë etnike.

- 1976:** Konventa Ndërkombëtare për të Drejtën Ekonomike Sociale dhe Kulturore hyn në fuqi, duke garantuar të drejtën për arsimim për të gjithë.
- 1981:** Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Femrës hyn në fuqi dhe thërret për të drejta të barabarta në arsimim.
- 1985:** Konferenca e Trete Botërore për Gra. Arsimiti është shpallur si bazë për përmirësimin e statusit të femrës.
- 1990:** Deklarata Botërore për Arsimim për të Gjithë në Jomtien, Tajlandë. Konferenca e bashkëspozorizuar UNDP-ja, UNESCO, UNICEF-i, dhe Banka Botërore e më vonë nga UNFPA, ka treguar konsensusin global për një vizion të zgjeruar për arsimimin.
- 1993:** Samiti i Arsimimit, E-9 në Nju Delhi. Përfaqësuesit e qeverive të 9 kombeve më të populluara të botës në zhvillim (Bangladeshit, Brazilit, Kinës, Egjiptit, Indisë, Indonezisë, Meksikës, Nigerisë, dhe Pakistanit), janë zotuar të arrijnë qëllimin e arsimimit fillor universal deri në vitin 2000.
- 1994:** Konferenca Botërore për nevojat Speciale të Arsimimit, Kyçjes dhe Barazisë në Salamankë. Pjesëmarrësit deklaruan se të gjitha vendet duhet t'i shkrijnë nevojat speciale të arsimimit në strategjinë e tyre vendore për arsimim.
- 1994:** Konferenca Ndërkombëtare për Popullim dhe Zhvillim. Shtetet pjesëmarrëse marrin qëndrim të promovojnë dhe të arrijnë qasje të barabartë universale të arsimimit kualitativ për të ndihmuar çrrënjosjen e varfërisë, promovimin e punësimit, integrimin në përkujdesjen sociale, me theks të veçantë në arsimimin e vajzave.
- 1996:** Ripohimi në takimin e Amanit në takimin e Mesdecenies të Forumit Ndërkombëtar Konsultativ për Arsimim për të Gjithë.
- 2000:** Korniza e Dakarit për Veprim u miratua në Forumin Botëror të Arsimimit në Senegal.

AKTIVITETE TË ZGJEDHURA

VEPRIMI I:

VEPRO !

PJESA I: HYRJA

Ky aktivitet ka për qëllim ta thellojë kuptimin e çështjeve të prezantuara në modulin e të drejtës për arsimim.

Lloji i aktiviteti: aktrim

PJESA II: PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM PËR AKTIN DRAMTIK

Qëllimet dhe Synimet

Teknika e aktrimit mund ta ndihmojë mësimin. Synimi i saj është që t'i bëjë pjesëmarrësit ta përjetojnë një situatë jo të zakonshme dhe ta zhvillojnë përjetimin dhe vlerën e pikëpamjeve të ndryshme.

Grupi i synaur: të rinjtë, të rriturit

Madhësia e grupit / organizimi shoqëror: rreth 20

Koha: 60 minuta

Përgatitja: lexim me kujdes i modulit të arsimimit

Materiali: fletët; markerët

Aftësitë e përfshira: aftësitë për gjuhë, aftësitë e bashkëpunimit, aftësitë e argumentimit, aftësitë kritike dhe ato kreative

PJESA III: INFORMATA SPECIALE PËR AKTIN DRAMTIK

Hyrje në temë

Shpjego synimin se ushtrimi duhet të vijë me një paraqitje dramatike të përmbajtjes së modulit për arsimim.

Kërko nga njerëzit që të ndahen në grupe të vogla (4-6) dhe çdo grupi jepi nga një fletë dhe marker.

Çdo grupi ia jep dhjetë minuta për të hedhur në letër të gjitha idetë për modulin dhe pastaj t'i përzgjedhin dy apo tri ide kyçe, të cilat do të shpreheshin më fuqishëm në aktin dramatik.

Tani ua jep grupeve 30 minuta që ta disenjojnë dhe të bëjnë prova. Shpjego se duhet të jetë përpjekje grupore dhe secili duhet të ketë një rol për vënien në skenë.

Pastaj, grupet mblidhen se bashku, në mënyrë që të gjithë të mund ta shohin shfaqjen e njëri-tjetrit.

Ua jepni disa minuta pas çdo shfaqjeje për vlerësim dhe diskutim

Kërkoni nga mbikëqyrësit dhe aktruesit që t'i shprehin mendimet e tyre.

Shfaqja e aktit dramatik

Formojeni një rreth, duke u kujdesur se ka vend të mjaftueshëm për shfaqje në mes të këtij rrethi.

Ia lejoni çdo grupi që ta aktrojnë “dramën” e tyre të vogël.

Paralajmërimet e organizimit:

Thërrisni “*ndal*” gjatë një momenti të një veprimi të gjallë dhe kërkoni nga aktorët të përshkruajnë emocionet e tyre në atë moment apo thërrisni të tjerët për të analizuar se çka po ndodh.

Pa paralajmërim, ndalo të gjitha veprimet, kërkoni nga aktorët t'i ndërrojnë rolet dhe vazhdoni veprimin aty ku keni mbetur.

Mbaj dikë pas çdo aktori. Ndërprite aktrimin në mes të rrugës dhe pyete “hijen” se çka mendon se karakteri i tyre ndien dhe mendon dhe përse ndodh ashtu.

Vlerësim:

Kontrolloje vetë rolin dramatik!

Si janë ndier njerëzit për këtë aktivitet? Çka ishte më vështirë apo më lehtë se ajo që së pari e imagjinuan? Cilat ishin aspektet më të vështira, apo çështjet më të vështira të pasqyruara?

A kanë mësuar njerëzit ndonjë të re?

Ku janë ngjashmëritë e ndryshimeve në mes të njerëzve, dhe nëse po, ku?

Këshilla metodologjike:

Roli dramatik mund të marrë shumë forma, por në të gjitha ato, pjesëmarrësit aktrojnë dramën e vogël të cilat normalisht shkaktojnë ndjenja të fuqishme tek aktori, por edhe te shikuesit. Prandaj udhëheqësi i grupit duhet të inkurajojë vlerësimin e asaj se çka ndodhi dhe pastaj ta analizojë në lidhje me të drejtat e njeriut.

Para se çdo grup ta nisë shfaqjen e tij, jepni instruksione të qarta dhe siguroni kohë të mjaftueshme për zhvillim të plotë dhe diskutim.

Bëhuni i ndieshëm për ndjenjat që roli mund t'i nxisë tek aktorët dhe shikuesit.

Lejo kohë për t'i pyetur të dy palët aktorët dhe shikuesit se si janë ndier

Inkurajo velrësimin se çka ndodhi dhe analizo në lidhje me modulën dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Sygerime për ndryshim:

Kryeje këtë aktivitet si një ushtrim vizatimi: bëni grupet të prezantojnë një poster dhe t'i shprehin idetë e tyre kryesore.

PJESA IV: VAZHDIMI

Shiko në dramën apo në literaturën tjetër me temë nga të drejtat e njeriut dhe organizo një shfaqje dramaturgjike për anëtarët e bashkësisë suaj lokale.

Të drejtat e tjera: Të gjitha të drejtat e njeriut

Burimi: Shtirirja: Doracaku për të Drejtën e Arsimit për Njerëzit e Rinj. Viti 2002. Cedex Strasbourg: Publikim i Këshillit të Evropës.

AKTIVITETI II:

KALLËPI ROMBOIK

PJESA I: HYRJE

Ky aktivitet ka për qëllim kuptimin e principeve dhe masave në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve (KDF-së) dhe ta ndërlihin atë me të drejtën për arsimim në veçanti.

Lloji i aktiviteti: Grupet punuese

PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME MBI USHTRIMIN

Qëllimet dhe Synimet:

Ky aktivitet merret me shqyrtimin e disa neneve të KDF-së për të përfituar kuptimin e të drejtës së çdo fëmije për të qenë i arsimuar.

Grupi i synuar: të rinjtë e moshës madhore

Madhësia e Grupit / organizmi shoqëror: rreth 20

Koha: së paku 60 minuta

Përgatitja:

Radhitni nenet 12, 13, 14, 17, 18, 27, 28, 29, 32 të KDF-së në një fletë të gjerë, për ta bërë një skicë në mur.

Pregatitni një grumbull të kartave të neneve për çdo grup

Materiali: grumbull të kartave në zarfe

Aftësitë e përfshira: gjuhësore, bashkëpunuese, argumentuese, kritike dhe reflektive

PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE MBI USHTRIMIN

Përshkrimi i aktivitetit/instrukcionet:

Filloni me një rishikim përbledhës të KDF-së. Pyetni njerëzit se çka dinë për të. Trego skicën e murit dhe lexo nenet kryesore.

Ndaje grupin në grupe të vogla. Shpërndaj zarfet me kartat e KDF-së.

Çdo grup i vogël duhet të diskutojë nëntë nene duke marrë parasysh se sa i rëndësishëm çdo njëri është për jetën e tyre. Pastaj ata duhet t'i rregullojnë në kallëpin romboik në bazë të rëndësisë së tyre – mbi të gjitha ata duhet të kenë 25 minuta për të diskutuar, vendosur dhe eventualisht rivendosur formën e kallëpit.

Kur grupet të përfundojnë, ato duhet të shikojnë se si i ka radhitur çdo grup nenet e tyre.

Pastaj ata mund të mblidhen për diskutim.

Grupi i synuar: të rinjërë, të rriturit

Madhësia e Grupit / organizmi shoqëror: rreth 20

Koha: 60 minuta

Përgatitja: lexim me kujdes i modulit të arsimimit

Materiali: hamerët; shënuesit

Aftësitë e përfshira: aftësitë për gjuhë, aftësitë për bashkëpunim, aftësi të argumentimit, aftësitë kritike dhe ato kreative

Vlerësimi / Evaluimi:

Fillo të thërrasësh çdo grup që t'i prezentojë rezultat e tij. Pastaj vazhdo rishikimin se si pjesëmarrësit e kanë pëlqyer aktivitetin dhe çka kanë mësuar.

Krijto disa pyetje si: ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes të grupeve; pse kemi prioritetet të ndryshme; cilat argumente ishin më bindëse, a ka ndonjë të drejtë që mungon në KDF, si është situata në bashkësinë tona?

Këshilla metodologjike:

Ndarja e pjesëmarrësve në grupe më të vogla ofron mundësi më të madhe për pjesëmarrje dhe bashkëpunim. Grupet e vogla punuese mund të prodhojnë ide shumë shpejt dhe inkurajojnë ndërlidhjen e përvojës personale me koncepte përmblendhëse.

Thekso se nuk ka mënyrë të drejtë apo të padrejtë të rregullimit të kartave!

Inkurajo pjesëmarrësit që të diskutojnë opinione të ndryshme dhe pozita!

Tërhiq vëmendjen për rëndësinë e arritjes së marrëveshjes përbrenda grupit!

Sygjerime për ndryshim:

Zgjidh njërin nga nenet dhe nëpërmjet artit, tregimit, poezisë, aktrimit etj., bëj një shfaqje që përfaqëson atë!

Lejo pjesëmarrësit ta zgjedhin një nen dhe të flasin për atë rreth një minutë!

PJESA IV: VAZHDIMI

Shiko politikat e menaxhimit të shkollave dhe planprogramin, për të parë se sa i përmbushin shkollat detyrat dhe përgjegjësitë lidhur me KDF-në.

Të drejtat e tjera: Të drejtat sociale dhe ekonomike dhe të gjitha të drejtat e tjera njerëzore.

Burimi: Të miratuara nga shtrirja: Doracaku për të Drejtën e Arsimimit me Njerëzit e Rinj. Viti 2002. Cedex Strasbourg: Publikim i Këshillit të Evropës.

BIBLIOGRAFIA

Dejvid Betham, 1998. *Të drejtat e njeriut: Dimensionet dhe sfidat e reja.* Edituar nga: Janus Simonides. *Demokracia dhe të drejtat e njeriut: civile, ekonomiko politike, sociale dhe kulturore. Doracak mbi të drejtat e njeriut. Publikim i UNESCO-s.*

Fons Komans, 1998. *Identifikimi i shkeljeve të së drejtës për arsimim.* Edituar nga Van Boven, Teho, Ses Flinterman dhe Ingrid Uesterndorp. *Udhëzimet e Mاستrihtit mbi shkeljen e të drejtës ekonomike, sociale dhe kulturore, SIM special nr. 20.* Utrecht: Instituti Holandez për të Drejtat e Njeriut.

Fons Komans, 1995. *Qartësimi i elementeve kyçe të së drejtës për arsimim.* Edituar nga Komans, Fons dhe Fred Van Hof. *E drejta për ankesë rreth të drejtës ekonomike, sociale dhe kulturore.* SIM special nr. 18. Utrecht: Instituti Holandez për të Drejtat e Njeriut.

Këshilli i Evropës. 2002. *COMPASS- Doracaku për të Drejtën e Arsimimit për Njerëzit e Rinj. Viti 2002.* Strasbourg: Këshilli i Evropës.

Ivet Daoudes dhe Kishor Sinh. 2001. *E drejta për arsimim: një analizë e instrumenteve për rregullimin e standardit të UNESCO's.* Paris. Publikuar nga UNESCO.

Asociacioni Gjerman për Kombet e Bashkuara. Raport për zhvillimin njerëzor . Bon: DGVN (për UNDP).

Alfred Fernandez dhe Zigfrid Jenker. 1995. *Deklaratat dhe Konventat Ndërkombëtare mbi të Drejtën për Arsimim dhe Liri të Arsimimit.* Frankfurt Main: Info3 – Verlag.

Daglas Hodgson. 1998. *Bashkëpunimi dhe Zhvillimi Ndërkombëtar mbi të Drejtën e Njeriut për Arsimim. Tekst shkollor.* Aldershot: Ashgate Publishing.

Qendra e Burimit të të Drejtave të Njeriut. *Qarku i të drejtave. Aktiviteti i të drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore: Burimet e trajnimit.* Në dispozicion në adresën e internetit: <http://hrusa.org/hrmaterials/IHRIP/circle/toc.htm>

Manfred Novak. 2001. *E drejta për arsimim në të drejtën ekonomike, sociale dhe kulturore.* Edituar nga Edie, Asbjorn, Katarina Kraus dhe Rosas Allen. E drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Tekst shkollor. Dordrecht: Martinus Nijhoff Publishers.

Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut. 1999. *Dekada e Kombeve të Bashkuara për Arsimim për të Drejtat e Njeriut (1995-2004) nr. 3. Përpilimi i masave rezervë të instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale që merren me të drejtën e njeriut për arsimim.* Gjenevë. Kombet e Bashkuara.

Amartya Seb. 2002. “Arsimi Bazë dhe Siguria Njerëzore” në “ Mbledhjen e punës në arsimim, paanësia dhe siguria ” mbajtur në Kalkutë, Indi, prej 2 deri 4 Janar 2002.

Janus Simonides. 2000. *Të Drejtat e Njeriut: Konceptet dhe Standardet.* Aldershot: Ashgate Publishing.

The Interdependent. Mujorja nr. 104, Shkurt 2002: www.nscentre.org

Katarina Tomashevski. 1999. *Raporti Preliminar i Raportuesit Special mbi të Drejtën për Arsimim,* dokument i KB. E/CN.4/1999/49. Po ashtu, shiko raportin e arritjeve të Raportuesit Special. Dok. i KB E/CN.4/2000/6.

UNICEF. 1999. *Kushtet e fëmijës botëror 1999.* Paris. UNICEF.

Kombet e Bashkuara. 2001. *Pekini drejt Pekinit +5 Rishikimi dhe vlerësimi i zbatimit të platoformës së Pekinit për raportin veprues të Sekretarit të Përgjithshëm.* New York.

Kombet e Bashkuara. 2001. *Ne njerëzit: Roli i Kombeve të Bashkuara në shekullin 21, shkrime njoftuese për studentët.* New York. Publikime të KB-së.

INFORMATA PLOTËSUESE

Arsimimi Ndërkombëtar: www.ie-ei.org

Qendra Bazë Elektronike për të Drejtën e Njeriut për Arsimim: <http://erc.hrea.org>

Dritarja për mësim elektronik në internet:

www.unesco.org/education/elearning

Shoqëria e për të Drejtën e Njeriut për Arsimim: www.hrea.org

Interneti i të Drejtave të Njeriut: www.hri.ca

Rrjeti i të Drejtave të Njeriut: www.derechos.net

Zyra e Komsionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut: www.unhchr.ch

E Drejta për Arsimim: www.right-ti-education.org

Lëvizja Pupullore për të Drejtën e Njeriut për Arsimim: www.pdhre.org

Banka Botërore: www.worldbank.org

Fondi i KB-së për Fëmijë: www.unicef.org

Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e KB-së: www.unesco.org

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim: www.undp.org

Forumi Botëror i Arsimit 2000: www.unesco.org/efa